



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:033006
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05517280

C.nr.517/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN– **Departamenti i përgjithshëm– Divizioni civil**, me gjyqtarin Baki Shigjeqi, duke vendosur në çështjen juridiko- kontestimore të paditësit L. K. me numër personal nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. B.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “DKUKAGJINI”, Sh.A. me seli në Prishtinë, për shkake të kompensimit të dëmit, vlera e deklaruar e kontestit njëmijë euro (1,000.00 €), jashtë seance, me datë 28.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET së është tërhequr padia me shenjën C.nr.517/2023 e datës 06.02.2023, e paditësit L.K. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “DKUKAGJINI”, Sh.A. me seli në Prishtinë, për çështjen juridike me objekt kontesti kompensim i dëmit material.

A r s y e t i m

Paditësi L.K. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij av. B.M. nga Prizreni, ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datë 06.02.2023, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “DKUKAGJINI”, Sh.A. me seli në Prishtinë, për shkake të kompensimit të dëmit, vlera e deklaruar e kontestit njëmijë euro (1,000.00 €).

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e datë 27.03.2024, e ka njoftuar gjykatën se në këtë çështje juridike kontestuese me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtë gjyqësore, dhe se në mungesë të interesit juridike për vazhdimin e ndjekjes së çështjes përmes Gjykatës e TËRHEQ PADINË.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 par.1 e lidhur me nenin 387 par.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:033006, 28.03.2024

Gj y q t a r i,

Baki Shigjeqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, në kuptim të nenin 261 par.4 të LPK-së, nuk është e lejuar ankesa.